**URDHËR**
**Nr. 283, datë 23.5.2019**

# PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PUBLIK, TË ARSIMIT PARASHKOLLOR "KOPSHTI" NË FSHATIN BULARAT, NJËSIA ADMINISTRATIVE DROPULL I SIPËRM, BASHKIA DROPULL

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike" dhe udhëzimit nr. 30, datë 12.9.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", me propozim të Bashkisë Dropull

URDHËROJ:

1. Hapjen e institucionit arsimor parauniversitar publik, të arsimit parashkollor, "Kopshti" pranë fshatit Bularat, njësia administrative Dropull i Sipërm, Bashkia Dropull, propozuar me vendim nr. 13, datë 20.2.2019 të Këshillit Bashkiak Dropull.
2. Bashkia Dropull të realizojë procedurat për emërimin e stafit drejtues dhe mësimdhënies të kopshtit, bazuar në normat e punës mësimore-edukative dhe propozimin e saj.
3. Kopshti të fillojë veprimtarinë e tij në vitin mësimor 2019–2020.
4. Bashkia Dropull të sigurojë ambientet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së kopshtit, sipas propozimit të saj.
5. Kopshti duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:
a) dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të fëmijëve dhe të mësuesve;
b) regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase;
c) rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit.
6. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit do të hapet kopshti, të monitorojë veprimtarinë mësimdhënëse të këtij institucioni arsimor parauniversitar publik, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe Bashkia Dropull.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
**Besa Shahini**